

BULETIN INFORMATIV 19 KORRIK 2022



KONFERENCA KOMBËTARE

RRJETI POP DHE KONTRATA SOCIALE SI MEKANIZMA PËR
TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE NDAJ QYTETARËVE



Konferenca Kombëtare **“Rrjeti POP dhe Kontrata Sociale si mekanizma për transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve”** u organizua me mbështetjen e Olof Palme International Center nëpërmjet Qeverisë Suedeze dhe National Endowment for Democracy.

PËRMBLEDHJE

Konferenca bëri bashkë dy programe që Rrjeti POP zhvillon: **Kontrata Sociale dhe Buxhetimi me Pjesëmarrje**. Aktiviteti u organizua në format hibrid ku morën pjesë përfaqësues nga 12 bashki ku rrjeti POP operon, organizata të shoqërisë civile, përfaqësues të pushtetit vendor dhe atij qendror.

Rrjeti POP - Përballja e Ofertave Politike po monitoron punën e 12 bashkive dhe këshillave bashkiakë për përmbushjen e Kontratës Sociale me prioritetet e qytetarëve prej vitit 2019. Gjatë këtij procesi, vëmendje e veçantë i është kushtuar mekanizmave të përdorur nga pushteti vendor për transparencë; llogaridhënie si dhe përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje.

Gjatë këtyre viteve, anëtarët e rrjetit POP kanë shërbyer si ura komunikimi mes qytetarëve dhe bashkive Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Kukës, Shkodër, Pukë, Pogradec, Kamëz, Elbasan, Korçë dhe Vau i Dejës duke forcuar kështu bashkëpunimin me qytetarët në përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel lokal.

Bazuar në raportet vjetore të monitorimit të kontratave sociale në bashkitë e sipërpërmendura, si dhe nga analizat e takimeve të drejtpërdrejta me qytetarët, shpeshherë rezultojnë se këta të fundit nuk kanë shumë informacion dhe/ose nuk njohin mekanizmat që bashkitë përdorin për t'i përfshirë në vendimmarrje. Për këtë arsye, anëtarët e rrjetit POP që nga maji 2022 kanë punuar për nxjerrjen e 12 raporteve individuale mbi mekanizmat që përdorin bashkitë për çështjet e sipërpërmendura dhe analizojnë gjetjet. Bashkitë respektive do të informohen për gjetjet dhe analizat si dhe do të shpërndahen raporte individuale dhe do të sugjerohet që të ndiqen rekomandimet e nxjerra nga POP. Ky është një proces i cili do të monitorohet në vazhdimësi paralelisht me monitorimin e Kontratës Sociale, pasi angazhimi i qytetarit, demokracia lokale dhe transparenca janë tre shtyllat kryesore për të cilat ne advokojmë gjatë punës tonë krahas prioritetëve të Kontratës Sociale.

Pjesëmarrja dhe përfshirja e qytetarëve në konsultim dhe vendimmarrje është një nga elementët kryesorë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë, ku zëri i të gjithëve dëgjohet para dhe gjatë procesit të vendimmarrjes, drejtpërdrejt dhe përmes organizatave të shoqërisë civile apo institucioneve përgjegjëse.

Një nga mekanizmat më efektivë të vendimmarrjes konsultative është buxhetimi me pjesëmarrje, i përdorur nga Rrjeti POP për të advokuar për përmbushjen dhe adresimin e prioritetëve të Kontratës Sociale. Për këtë arsye, Udhëzuesi i Procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje është zhvilluar dhe do të shpërndahet në të 61 bashkitë e vendit, për ta kthyer BP-në në një proces të qëndrueshëm dhe të institucionalizuar.

Ky aktivitet u përshëndet nga znj. Petra Burcher – Shefe e Bashkëpunimit për Zhvillim - SIDA, Ambasada Suedeze në Tiranë dhe znj. Alma Bime, Drejtoreshë e Drejtorisë së Koordinimit dhe Monitorimit të Prefekturave pranë Ministrisë së Brendshme.

ZNJ. PETRA BURCHER

Shefe e Bashkëpunimit për Zhvillim -
SIDA, Ambasada Suedeze në Tiranë

U frymëzua shumë kur pamë se mund të jepni shpresë dhe të krijoni ndjenjë se për qytetarët mund të bëhen ndryshime. Në këtë rast, bëhej fjalë për mobilizimin e komunitetit në zonën rurale dhe kërkesën për rikonstruksionin e shkollës dhe nëse më kujtohet mirë, mendoj se bëhej fjalë për një qëllim sanitar dhe gjetjen e një zgjidhjeje për tualetet e duhura të kësaj shkolle në zonën rurale; **dhe garantimi i tyre se mirëqenia dhe siguria e shkollës nuk ishte një çështje për t'u kërkuar një favor autoriteteve, por kërkonte një të drejtë. Kjo ndodhi në fshatin e vogël të Korçës me ndihmën tuaj.**



Kur takuam kryetarin e Bashkisë së Korçës dhe stafin e tij, ishte shumë interesante të dëgjoje, që e vlerësonin me nota mjaft pozitive mbështetjen në zërat e qytetarëve dhe organizata si ju. Pra, ky ishte një bashkëpunim shumë konstruktiv.


Ambasada porositi së fundmi një vlerësim të mbështetjes për programin OPC në Shqipëri. Dhe rrjeti POP ishte një nga ndërhyrjet për të cilat ne kishim një interes të veçantë. Jo çuditërisht, gjetjet fillestare tregojnë dhe po citoj vlerësuesit, se *“Rrjeti POP është një hapësirë unike për dialog në një kontekst të zvogëlimin të hapësirës mes qytetarëve dhe bashkive.”* Pra, urime! Kjo tregon gjithashtu se POP ka arritur të mobilizojë si pushtetin vendor, ashtu edhe deri diku qytetarët, dhe shumë është bërë me shumë pak burime. Ndaj, gjej rastin t'ju falenderoj ju, anëtarët e rrjetit POP për punën tuaj, si dhe Aleancën Gjimore për Zhvillim për udhëheqjen, koordinimin dhe qasjen koherente. Gjithashtu dua të falenderoj bashkitë dhe Ministrinë për bashkëpunimin e tyre me organizatat e shoqërisë civile, e cila ndihmon në tejkalimin e hendekut mes zyrtarëve dhe qytetarëve. Pra, bravo!

Kolegët e mi dhe unë shpesh marrim pyetje në lidhje me praktikat në Suedi dhe si angazhohen qytetarët në vendimmarrje. Dialogu me qytetarët ndërmjet zgjedhjeve në Suedi është bërë gjithashtu gjithnjë e më i rëndësishëm për autoritetet lokale dhe rajonet në Suedi. Kjo është pjesërisht e nxitur nga sfidat me të cilat përballemi edhe në shoqërinë tonë demokratike. Për shembull, rënia e anëtarësimit në partitë politike, pabarazitë e mëdha në pjesëmarrjen e votuesve ndërmjet zonave zgjedhore dhe mungesa e besimit në rritje tek politikanët dhe forma të ndryshme të përfshirjes sociale. Pra, angazhimi i qytetarëve dhe gjetja e mënyrave për ta bërë dialogun të strukturuar dhe sistematik janë sfida jo unike për Shqipërinë.

Por Shqipëria ka eksperiencat, njohuritë dhe ekspertizën e saj. Njerëzit në këtë dhomë, por edhe shumë njerëz jashtë janë të mbushur me shpresë për zhvillim dhe përparim.

Politologia dhe shkrimtarja shqiptare Lea Ypi, autorja ime e preferuar kohët e fundit, shkruan: *“Shpresa nuk është një detyrë morale. Ne duhet të veprojmë sikur ka mundësi që gjërat të shkojnë në rrugën që është e favorshme për atë që duam të arrijmë.*

Nëse do të ishim nihilistë, nuk do të mund ta mbanim atë ndjenjën e detyrës. "Veprimi" është fjala kyçe në këtë detyrë morale." Dhe sot, në një shënim personal, jam më shpresëdhënëse se sa kam qenë për një kohë shumë të gjatë. Unë jam shumë e emocionuar, pothuajse po aq e emocionuar sa kur isha fëmijë në Krishtlindje. Unë jam duke pritur për këtë vendim shumë të rëndësishëm që shpresoj se do të merret sot në Bruksel për hapjen e negociatave për Shqipërinë. Nuk e di nëse e kuptoni se sa e emocionuar jam për ju dhe për ne, por jam jashtëzakonisht e emocionuar. Sepse e ardhmja është tani këtu, edhe një herë, prandaj ka edhe shumë shpresë. Pra, faleminderit!



ZNJ. ALMA BIME

Drejtoreshë e Drejtorisë së Koordinimit dhe Monitorimit të Prefekturave pranë Ministrisë së Brendshme

Është kënaqësi të përshëndes këtë konferencë kombëtare organizuar nga rrjeti POP dhe në emër të Ministrisë së Brendshme, t'i uroj suksese të mëtejshme. Znj. Kuko që do të ishte prezente në emër të institucionit tonë, ndodhet në Bruksel si pjesë e ekipit të Qeverisë Shqiptare për çeljen e negociatave dhe sot është një ditë e shënuar për të gjithë ne, jemi në pritje dhe urojmë për çeljen e tyre.

Në Ministrinë e Brendshme, ne punojmë çdo ditë të jemi krah qytetarit jo vetëm për të ofruar shërbime sa më cilësore, por edhe për të rritur informimin publik dhe fuqizuar pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje. Njoh nga afër dhe vlerësoj punën që organizatat lokale të Rrjetit POP për të rritur zërin qytetar përmes përgatitjeve të 12 raporteve për informimin, njoftimin dhe konsultimin publik nga pushteti vendor. Ndërsa ne mirëpresim rekomandimet nga raportet jemi këtu së bashku, 12 bashki të reflektojmë dhe të diskutojmë mbi mënyrat si qeverisja qendrore, lokale dhe organizatat e shoqërisë civile mund të punojnë bashkë me dhe për qytetarët. Gjithashtu së bashku me prefekturat e bashkitë e Shqipërisë, në bashkëpunim me ministrinë e Brendshme dhe atë të Financave e të Ekonomisë paraqesim sot një udhëzues të unifikuar për procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje. Së fundmi jemi bërë pjesë e trajnimeve në rajone të Shqipërisë për të njohur udhëzuesin dhe për ta bërë pjesë së punës sonë të përditshme duke fuqizuar bashkëpunimin midis bashkive dhe qytetarëve për këtë proces shumë të rëndësishëm. Falenderojmë gjithë bashkëpunëtorët që përmes kontributit të tyre, ndihmuan në përgatitjen e një dokumenti, bazuar mbi përvojat e mira, praktika dhe dokumente ligjore që unifikojnë procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje në nivel vendor.



SESIONI I: QEVERISJA DHE DEMOKRACIA VENDORE

Metodologjia dhe prezantimi i gjetjeve kryesore të studimit të Rrjetit POP mbi mekanizmat për transparencë, llogaridhënie, informim dhe konsultim në vendimmarrje. Prezantimi i metodologjisë dhe gjetjeve kryesore të Raportit studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”



ZNJ. ESMERALDA HOXHA

Koordinator e Rrjetit POP

Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim"

Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik në 12 bashkitë ku rrjeti operon janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash, të tilla si: **a) hartimi i metodologjisë dhe instrumentit të anketimit (dy pyetësorë); b) kërkim dhe analizim të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) dhe kuadrit rregullator e ligjor përkatës; c) intervista të thelluara me stafin e bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; d) analizim dhe përpunim të të dhënave të anketimit dhe e) përgatitja e raportit së bashku me rekomandimet përkatëse.**

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përpiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetaret pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar. Për shembull faqet zyrtare të bashkive duhet të jenë më miqësore për publikun, regjistri i kërkesë ankesave duhet të përditësohet vazhdimisht, programet e transparencës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultohen me qytetarët, bashkitë duhet të përdorin një numër të konsiderueshëm mjetesh dhe formash për njoftimin dhe informimin e qytetarëve. Proceset e konsultimeve realizohen në bashkitë pjesëmarrëse por më shumë duhet te punohet për rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t'u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

KONKLUZIONE KRYESORE - 12 BASHKI

- Pavarësisht arritjeve të deritanishme, realizimi i procesit të konsultimit publik ka ende nevojë për përmirësime. Kjo kërkon rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t'u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.
- Duke qenë se jo të gjithë qytetarët janë të familjarizuar me përdorimin e faqes zyrtare dhe aksesin e informacionit online, nevojitet informim i vazhdueshëm i qytetarëve nëpërmjet takimeve publike.
- Faqet web rekomandohet të jenë miqësore dhe të lehta në përdorim;
- Procesi i dixhitalizimit të shumë shërbimeve krijon vështirësi në aksesin e informacionit apo shërbimit për shumë qytetarë, prandaj duhet të krijohet infrastruktura e nevojshme për komunikim me të gjithë banorët.
- Ofrimi i një pakete të plotë trajnimi për anëtarët e Këshillit Bashkiak por dhe për stafin e bashkive, kryesisht në lidhje me informimin publik, njoftimin dhe konsultimin.

SESIONI I: QEVERISJA DHE DEMOKRACIA VENDORE

- Praktikimi sa më shpesh i dëgjesave publike për t'i kthyer ato në procese ndikuese në komunitet, duke nxitur edhe rritjen e besimit.
- Aktivitetet e NJA (sidomos atyre që janë më larg qytetit) duhet të jenë në koherencë me aktivitetet që organizon bashkia dhe NJA që janë më afër qendrës.
- Është e nevojshme të bëhen publike në mënyrë të vazhdueshme rekomandimet e komunitetit që janë marrë parasysh gjatë procesit të konsultimit publik të projekteve vendore.
- Regjistri elektronik, regjistri i peticioneve dhe nismave qytetare duhet të përditësohen periodikisht.
- Realizimi i procesit të konsultimit publik ka nevojë për përmirësime, pasi duhet të nxiten qytetarët të marrin pjesë sa më shumë në diskutime publike. Gjetja e një mënyre atraktive për publikun dhe qytetarët është shumë e nevojshme.
- Të hartohen raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes.
- Bashkia duhet të përditësojë sa më shumë kanalet e saj të informimit dhe komunikimit me qytetarët dhe format e shprehjes së informacionit duhet të jenë edhe në kuadër të të dhënave dhe jo vetëm si reklamim i punëve që bën bashkia



Z. LAVDRIM SHEHU

Menaxher projekti

Qendra për Progres Rinor, Kukës

Si pjesë e rrjetit POP ka vite që kemi krijuar këtë partneritet dhe më vjen mirë që ne si organizatë e vogël në Kukës kemi mundësinë që të flasim me qeverinë e madhe. Në këtë raport do të targetojmë qeverisjen vendore në dy pjesë shumë të rëndësishme që është administrata e cila punon për institucionin dhe kryetarin e bashkisë dhe pjesa tjetër që është shumë e rëndësishme Këshilli bashkiak. Diskutimi dhe qasja për informimin e publikut, pjesëmarrja, konsultimi paraprak dhe angazhimi janë çështje shumë të domosdoshme sepse i shërbejnë përmirësimit të punës dhe jetesës së qytetarëve.

Për realizimin e raportit në Kukës, është ndjekur e njëjta metodologji si në bashkitë e tjera: Grupi i targetuar me anë të pyetsorëve: Punonjës të Administratës dhe Anëtarë të Këshillit Bashkiak. Disa gjetje specifike dhe konkluzione pas analizimit dhe duke mos përmendur sa u përmbledhën më sipër:

- Transmetimi i plotë, online në rrjete sociale, me live stream i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pozitiv pasi është i aksesueshëm dhe i përshtatshëm për t'u ndjekur edhe në kohë apo orar tjetër nga qytetarët.
- Faqet online të bashkisë përdoren shumë për reklamim dhe pasqyrim të arritjeve të bashkisë dhe nuk fokusohet te dhënia e informacionit të qartë, të vlefshëm dhe të vazhdueshëm për qytetarët.
- Përdorimi i peticioneve iniciuar nga grupe të interesit apo palë të interesuara është mekanizëm efektiv lobues dhe mënyrë e mirë për të angazhuar qytetarët.
- Zonat rurale janë pak të përfshira në procese të rëndësishme ku edhe ata vetë janë apo mund të jenë palë të interesuara. Sigurimi i përfshirjes cilësore, sfidë.
- Zbatimi i rregullores së Këshillit Bashkiak e cila detyron KB të kryejë konsultime periodike në secilën NJA është i domosdoshëm. Realizimi faktik, sfidë.

SESIONI I: QEVERISJA DHE DEMOKRACIA VENDORE



ZNJ. ENTELA MAÇKA

Drejtoreshë Ekzekutive

Gruaja në Zhvillim Korçë

Ne besojmë fort në faktin e të qenurit pjesë e këtij rrjeti që na jep mundësinë që jo vetëm të rritemi profesionalisht nëpërmjet ndarjes së eksperiencave dhe të njohurive tona por njëkohësisht e konsiderojmë një çelës shumë të nevojshëm i cili na ndihmon për të arritur objektivat tona në një mënyrë sa më efektive. Në prezantimin e mëposhtëm do të fokusohem në disa çështje kryesore të dalta nga raporti që ne si organizatë realizuam për bashkinë Korçë.

Nga monitorimi, analiza e të gjitha medimeve, formave për informimin, njoftimin, konsultimin dhe analiza e rezultateve të të intervistuarve u konstatuan se:

- Bazuar në përgjigjet e të intervistuarve, 1/3 e nëpunësve të Bashkisë Korçë kanë nevojë për një njohje më të mirë të bazës ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore dhe sidomos më tepër vështirësi vërehet tek administratorët nga zonat perurbane.
- Dokumentacioni që publikohet tek Programi i Transparencës përmban informacion të aksesueshëm për të gjithë qytetarët dhe është i mirëstrukturuar. Ai është lehtësisht i përdorshëm, pasi mund të shkarkohet dhe të printohet. Programi i Transparencës për Bashkinë Korçë do të ishte më lehtësisht i identifikueshëm nëse do të ishte pozicionuar tek rubrikat kryesore të menusë në faqen zyrtare të bashkisë.
- Në prokurimet publike paraqitet objekti i prokurimit, si dhe vlera e kontratës, por mungon përmbajtja.
- Në Bashkinë Korçë, Drejtoresha e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin Qytetar kryen njëkohësisht edhe funksionet e Koordinatorës së të Drejtës për Informim dhe të Koordinatorës për Njoftim dhe Konsultim Publik.

REKOMANDIME

- Koordinator i për Njoftimin dhe Konsultimin Publik ka një rol të rëndësishëm dhe me detyra të përcaktuara qartë në procesin e realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike. Rekomandohet që ky pozicion të mbulohet nga një person.
- Të hartohen raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes.
- Të përmirësohen dhe shtohen elementë të rëndësishëm për prokurimet publike dhe të pasqyrohet e publikohet informacioni në lidhje me donacionet, shumat dhe qëllimet e tyre tek Programi i Transparencës.

Në lidhje me rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe këshilltarëve vendorë, rekomandohet realizimi i trajnimeve si më poshtë:

- Për rritjen e njohurive mbi kuadrin ligjor për njoftimin, informimin dhe konsultimin në nivel vendor për target grupet që kanë realisht nevojë.
- Për ndërtimin e marrëdhënieve reale midis organeve të zgjedhura, ekzekutive dhe qytetarëve për informim para dhe pasi të merren vendimet.
- Për buxhetet vendore, bërjen e tyre lehtësisht të lexueshëm dhe kuptueshëm nga të gjithë, si dhe prezantimin e thjeshtë për publikun në procesin e konsultimit.
- Për këshilltarët e ardhshëm, të trajnohen, sepse duhet të rrisin njohuritë dhe kapacitetet qysh në marrjen e mandatit të tyre.

SESIONI I: QEVERISJA DHE DEMOKRACIA VENDORE

Mekanizmat më efektivë që bashkitë kanë përdorur për angazhimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve.



Z. BEKIM MEMA

Drejtoria e Planifikimit Strategjik

Bashkia Shkodër

Bashkia Shkodër, që pas reformës administrative-territoriale, ka bashkëpunuar ngusht me partnerët ndërkombëtarë në fushën e qeverisjes vendore, duke u fokusuar në implementimin e mekanizmave që nxisin përhapjen e informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut, qytetarëve, bizneseve dhe grupeve të interesit në menaxhimin e bashkisë. Ne kemi synuar që të kemi gjithëpërfshirjen sa më aktive dhe masive të të gjithë aktorëve të territorit.

Që në 2016-ën është implementuar një nga mekanizmat që mund të them është ndër më të rëndësishmit për mirëmenaxhimin e bashkisë dhe për përfshirjen sa më të mirë e të qëndrueshme të qytetarëve. Ky mekanizëm është sistemi i zyrave me një ndalesë. Përmes këtij mekanizmi ne kemi facilituar për qytetarët dhe banorët e bashkisë, nga zonat malore në bregdet, komunikimin dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset dhe punët e bashkisë. Përmes këtyre zyrave me një ndalesë, të cilat janë të vendosura në çdo njësi administrative të bashkisë, jepen rreth 72 shërbime për qytetarët, duke lehtësuar kështu aksesin e tyre në bashki, pa pasur nevojë që ata të humbin kohë për të ardhur dhe për të aplikuar në zyrat e bashkisë, ose për të komunikuar me stafet e bashkisë. Atyre u mjafton që të aplikojnë tek këto zyra me një ndalesë për gjithësecilin nga shërbimet që kanë nevojë, dhe brenda afateve ligjore në respektim të rregulloreve që kemi, secili nga këta banorë do të marrë përgjigjen e tij.

Me idenë që të kemi një faqe sa më interaktive për qytetarët, një tjetër platformë shumë e rëndësishme është platforma e transparencës së buxhetit. Bashkia, që në vitin 2016, ka të pasqyruar të gjithë buxhetin e bashkisë, me të gjithë zërat përkatës të shpenzimeve, duke vendosur edhe atë që për ne institucionet është pak e vështirë, dhe ndoshta kemi pak frikë që ta japim gjithë këtë informacion, por kur vjen puna shembulli konkret na ka rezultuar shumë i mirë, pasi në këtë platformë kemi pasqyruar çdo kontratë që kemi të lidhur me operatorët ekonomikë. Jemi munduar ta bëjmë këtë në mënyrë të tillë që çdo grup interesi, organizatat e shoqërisë civile që zhvillojnë studime, bizneset, apo edhe vetë qytetarët ta shohin se cila ka qenë forma e zbatimit dhe e shpenzimit të të ardhurave të tyre; sa transparente ka qenë kjo formë, sa ekonomike ka qenë kjo formë. Dhe ne i kemi krijuar mundësinë çdo qytetari që, përmes një klikimi të thjeshtë në faqen e internetit, të marrë informacion dhe të ketë dijeni për çfarë bashkia realizon dhe çfarë bashkia shpenzon. Kjo ka lehtësuar shumë punën tonë dhe janë këto qasje që kemi pasur ndaj faqes së internetit, pra që ta kemi sa më interaktive dhe të kemi një sistem informatik i cili e ndihmon punën e bashkisë, por që të ndihmojë edhe punën e qytetarëve dhe bizneseve, duke përçuar informacionin tek ata.

SESIONI I: QEVERISJA DHE DEMOKRACIA VENDORE

Mekanizmat më efektivë që bashkitë kanë përdorur për angazhimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve.



ZNJ. FLORINA KASHI

Koordinatorja e të drejtës së informimit
Bashkia Kamëz

Sa i përket modelit të transparencës, nuk mund të lëmë pa përmendur bashkëpunimin ndërmjet drejtorive, që bënë të mundur dhënien e informacionit në web. Programi i transparencës është lehtësisht i aksesueshëm në bashkinë Kamëz dhe mund të gjendet shumë thjesht duke klikuar dhe duke u shfaqur direkt me një link. Programi i transparencës përfshin shtatë pika kryesore të cilat kanë edhe nënçështjet e tyre që janë po ashtu me link, gjë që e bënë edhe më të aksesueshëm për qytetarët e thjeshtë.

Mund të them për ndarjen territoriale, për buxhetin, vendimet e këshillit bashkiak, kalendarin e mbledhjeve të këshillit bashkiak, mekanizmat për monitorimin dhe kontrollimin, kartën e auditit të brendshëm, transparencën dhe llogaridhënien ekonomike e financiare, të cilat janë në web me të gjitha nënçështjet e tyre. Mund të përmend kërkesat për informim, regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, i cili përditësohet çdo tre muaj dhe është me të gjitha kategoritë kryesore të tij. Mbi shërbimet që ofron bashkia, shërbimet në infrastrukturë, shërbimet sociale. Tek fusha 5, legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore; organizimi dhe funksionimi i bashkisë. Për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, edhe tek procesverbali i mbajtur për mbledhjet e këshillit bashkiak, i gjithë sekretariati i këshillit bashkiak bënë të mundur që qytetarët të jenë prezent në mbledhjet e këshillit bashkiak.



SESIONI II: BUXHETIMI ME PJESËMARRJE

Buxhetimi me Pjesëmarrje, si një mekanizëm efektiv i vendimmarrjes së konsultuar



ZNJ. ALKETA LAMANI

Menaxhere Projekti

Qendra Rinore e Vlorës

Pjesëmarrja dhe përfshirja qytetare në konsultim dhe vendimarrje është një nga elementët kryesorë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë, ku zëri i të gjithëve dëgjohej para dhe gjatë procesit të vendimmarrjes, si në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu edhe përmes organizatave të shoqërisë civile apo institucioneve përgjegjëse.

Si në çdo proces planifikimi në përgjithësi, edhe në rastin e planifikimit buxhetor rëndësi duhet t'i jepet më shumë procesit.

Jo se bërja e buxhetit në vetvete është më pak e rëndësishme, por kur ai hartohet përmes një plani të mirëpërcaktuar, gjithëpërfshirës, të konsultuar dhe transparent, është edhe më i arrirë. Buxheti duhet të jetë i qytetarëve dhe si i tillë, duhet të ketë përfshirjen dhe konsultimin me qytetarët, të cilët duhen orientuar dhe angazhuar në këtë proces.

Udhëzuesi përmban procedura dhe praktika të mirëpërcaktuara të buxhetimit me pjesëmarrje të cilat do ta rregullonin më tej këtë proces. Ky udhëzues sygjerohet si një model praktik për bashkitë me hapa e përgjegjësi konkrete, i cili do të lehtësonte zbatimin e këtij procesi dhe rritjen e pjesëmarrjes dhe angazhimit të qytetarëve në qeverisjen vendore. Udhëzuesi për Buxhetimin me Pjesëmarrje do t'u vihet në dispozicion njësive të qeverisjes vendore me synim përmirësimin e vendimmarrjes lokale përmes mekanizmave të tillë si Buxhetimi me Pjesëmarrje në zbatim të ligjit dhe në dobi të komunitetit.

PËR ÇFARË SHËRBEN UDHËZUESI

- Analiza e vlerësimit të situatës së buxhetimit me pjesëmarrje dhe konsultimit në nivel vendor tregoi mungesën e modeleve të Buxhetimit me Pjesëmarrje. Në pesë bashkitë subjekt i vlerësimit, modelet ishin të ndryshme dhe nuk kishte një model mbizotërues.
- Nga analiza dhe vlerësimi u evidentua se procesi BP është akoma në fazë zhvillimi, ka konfuzion në të kuptuarin e tij dhe më kryesorja është i pastandardizuar edhe në secilën NJQV.
- Ky udhëzues paraqet dhe sugjeron disa mekanizma të qartë dhe praktikë për bashkitë, kryesisht ata që përfshihen në planifikim, realizim dhe vlerësim të buxhetit, si dhe qytetarët (gratë/vajzat dhe burrat/djemtë), që marrin pjesë në aktivitetet e këtij procesi ose që përfshihen në iniciativa qytetare.
- Udhëzuesi siguron që rezultatet pozitive të arritura nga proceset e BP të jenë cilësore, të përfaqësojnë nevojat dhe prioritetet e qytetarëve dhe të promovojnë pjesëmarrjen demokratike qytetare në çdo komunitet.

Buxhetimi me Pjesëmarrje duhet kuptuar si proces i bashkëmenaxhues, pra një mekanizëm ku bashkia dhe qytetarët janë bashkë për të caktuar, shpenzuar dhe raportuar për burimet publike. Për të arritur objektivat e tij BP duhet të përfshijë të gjithë aktorët e interesuar (qytetarët, përfaqësuesit nga shoqëria civile lokale, qeverisjen, këshillat lokalë dhe komunitetin e biznesit).

SESIONI II: BUXHETIMI ME PJESËMARRJE

Buxhetimi me Pjesëmarrje, si një mekanizëm efektiv i vendimmarrjes së konsultuar



Z. DRITAN LELI

Kryetar

Bashkia Vlorë

Buxhetimi me pjesëmarrje është bërë një praktikë e plotë e punës në bashkinë e Vlorës, sigurisht falë mbështetjes së donatorëve, përfaqësueses së organizatës që gjithashtu foli dhe është një nga njerëzit që monitoron në çdo hap bashkinë e Vlorës dhe jo vetëm, duke treguar një lloj rigoroziteti në një gjë që vërtet i vlen qytetit dhe menaxhimit të bashkive në të gjithë territorin e Shqipërisë.

POP ka qenë vërtet një nga iniciativat e bukura që unë i kam mbështetur dhe që japin gjithmonë rezultatin pozitiv sepse njerëzit shpesh harrojnë të komunikojnë. Në momentin që ti je në karrige pushteti, të bën vetë puna që të distancohesh nga gjëja dhe të duken ndonjëherë rutinore. Por mendoj që përballja me ofertat dhe pikërisht buxhetimi me pjesëmarrje është ai momenti kur ti ke përballë qytetarët, atë nënën me fëmijë që nuk e do atë gropën tek lagjja e vet dhe që mund t'i prishë ditën. Unë mendoj që ata që e kanë iniciuar kanë gjetur mënyrën më të mirë për të monitoruar fondet publike. Në momentin që këto diskutohen me komunitetin dhe vendosen prioritetet e shtëpisë së madhe që është bashkia e qytetit, atëherë qytetarët janë mbështetës. Sepse në fund fare thonë ne votuam që të bëhen këto dhe vitin tjetër kur të gjenden fondet të vazhdojmë me projektet e tjera të komunitetit. Nuk besoj se ka gjë më të mirë sesa buxhetimi me pjesëmarrje për të arritur tek qytetarët dhe për mbërritjen e tyre në zyrat bashkiake, sepse kontakti i drejtpërdrejtë është pikërisht ai që të jep motivin për të gjetur zgjidhjen më të mirë, për të parë se kush është indikator i më i rëndësishëm i zhvillimit në një qytet kur ndonjëherë administrata burokratike duket sikur humbet lidhjen.

Kështu që unë dua t'ju falenderoj shumë për ftesën që më keni bërë, gjithë organizatorëve, GADC-së sigurisht për kujdesin e veçantë që tregon në bashkërendimin e punëve me të gjitha bashkitë në gjithë Shqipërinë dhe t'ju falenderoj edhe ju të gjithë që jeni prezent sot dhe keni kurajon e durimin që në një temperaturë kaq të lartë sot të na dëgjoni dhe të jepni mbështetjen tuaj për aktivitete të rëndësishme. Sigurisht edhe Ambasadën e Suedisë për mbështetjen që ka dhënë në të gjitha këto iniciativa që ne realizojmë, pa të cilat do të ishte jo kaq e kollajtë për të arritur të bësh punë të mira.



SESIONI II: BUXHETIMI ME PJESËMARRJE

Buxhetimi me Pjesëmarrje, si një mekanizëm efektiv i vendimmarrjes së konsultuar



Z. FRAN BRAHIMI

Drejtor i Financave Vendore

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Është kënaqësi që jam në këtë konferencë për të dhënë opinionet dhe konsideratat e mia për një problem shumë të rëndësishëm me të cilin vazhdojmë të ballafaqohemi. Ne kemi vite e vite që punojmë me buxhetimin, madje unë kam pjesën më të madhe të karrierës sime që merrem me buxhetimin dhe sigurisht që sfida më e madhe në dije dhe në praktikë është buxhetimi me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit. Është një nga sfidat më të rëndësishme; le të themi është antibiotiku më i mirë i të gjithë procesit të buxhetimit.

S'ka gjë më të mirë sesa të flasim sot për buxhetimin me pjesëmarrje. Problemet e buxhetit janë probleme kudo të debatueshme. Janë probleme për të cilat, në të gjitha vendet e botës, kërkesat e qytetarëve janë shumë herë më të mëdha sesa mundësitë. Instrumenti më i mirë i marrjes së maksimumit të mundshëm të vendimeve të duhura për buxhetimin, është buxhetimi me pjesëmarrjen e tyre. Kudo kërkesat, nevojat, presionet janë të mëdha. Por në qoftë se ne kemi një linjë të drejtë komunikimi me ata që kontribuojnë dhe i dëgjojmë e bisedojmë me ta, është e vërtetuar praktikisht dhe shkencërisht që vendimet janë më të mirat e mundshme. Meqenëse kemi kërkesa më shumë sesa mundësira, gjithmonë duhet të zgjedhim ato që janë më të mirat. Jo më kot quhet një betejë e vazhdueshme, e cila fitohet vetëm me pjesëmarrjen e komunitetit. Pra një betejë midis atyre që e ofrojnë dhe atyre që marrin pjesë në të.

Unë e kam pritur me kënaqësi kur jam ftuar për të kontribuar sadopak në gjithë këto aktivitete dhe kryesisht në një udhëzues për përdoruesit, për të kontribuar se ku duhet të orientohemi më shumë tek buxhetimi me pjesëmarrje. Të gjitha reformat e ndërmarra në nivel vendor janë të përshkuara nga pjesëmarrja e publikut. Askush nuk ballafaqohet më shumë me qytetarët sesa drejtuesit dhe stafet vendore. Në qoftë se flasim për ministrinë ku unë bëj pjesë, jemi krejt në periferi krahasuar me ata që janë në frontin e parë që janë bashkitë. Në këtë kontekst, buxhetimi me pjesëmarrje përshkruhet në hapa, procese, procedura të ndryshme. Por sigurisht që ky aktivitet, ky dokument që ne e kemi këtu dhe të gjitha këto investime që ne po bëjmë, në njëfarë mënyre japin një formalizim se si duhet të organizohemi për të marrë mendimin më të mirë të mundshëm nga ata që kontribuojnë në buxhetin e një bashkie, qarku, apo edhe në buxhetin e një vendi.

Sot prezantohet Udhëzuesi i Buxhetimit me Pjesëmarrje që jep njëfarë procedure se si duhet të punohet me buxhetimin me pjesëmarrje. Tërë filozofia e kuadrit ligjor dhe tërë reforma që është e fokusuar tek financat publike dhe kryesisht vendore, është e përqendruar tek transparenca, pjesëmarrja qytetare, eficientia dhe efektiviteti i financave publike. Ky manual na rikujton disa nga hapat që ne i kemi zbatuar edhe më përpara, por tani duke patur një manual të tillë, jemi më të sigurtë dhe më të organizuar në lidhje me atë çfarë duhet të bëjmë nga fillimi deri në fund për procesin e buxhetimit.

SESIONI II: BUXHETIMI ME PJESËMARRJE

Buxhetimi me Pjesëmarrje, si një mekanizëm efektiv i vendimmarrjes së konsultuar



Z. ERVIN MUÇO

Drejtor

Kabineti i kryetarit të Bashkisë Elbasan

Rëndësia e partneritetit me shoqërinë civile është e madhe, jo thjesht në termat të buxhetimit dhe pjesëmarrjes por edhe të mënyrës sesi ne organizojmë punët tona si bashki në bashkëpunim me shoqërinë civile por njëkohësisht dhe me aktivizimin e shoqërisë në terësi në adresimin e problematikave deri në zgjidhjen e tyre. Në këtë kontekst të gjithë jemi dakort që partneriteti i fortë mes organizatave të shoqërisë civile dhe qeverisjes lokale është i rëndësishëm pasi na mundëson të indentifikojmë këto nevoja, të gjejmë zgjidhje më të mira për to dhe njëkohësisht edhe të kemi një ndikim të mirë në shoqëri.

Bashkia Elbasan e ka ndërtuar këtë partneritet me shoqërinë civile, është një partneritet i qëndrueshëm prej vitesh dhe mbështetet të paktën në 4 shtylla kryesore: Partneriteti strategjik me aktorë shumë të rëndësishëm lokal dhe përtej saj, është bashkëpunimi i përditshëm që ne kemi më këta aktorë, të të kuptuarit të përbashkët rreth sfidave dhe problematikave dhe shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira.

Të katër shtyllat e mësipërme kanë drejtuar dhe janë kthyer në fiziolofinë e punës së bashkisë së Elbasanit. Në lidhje me buxhetimin me pjesëmarrje ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me shoqërinë civile e cila është lehtësuese dhe ndihmon shumë në organizimin e këtyre takimeve. Rëndësi të madhe zënë edhe strukturat komunitare. Janë struktura të cilat janë ngritur në kuadër të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike, qëllimi i të cilave është që të përfaqësojnë sa më mirë komunitetin ku ata jetojnë, në përditshmërinë e tyre.

Për t'iu rikthyer edhe një herë Buxhetimit me Pjesëmarrje, ne i kemi kushtuar rëndësi disa aktorëve apo grupeve të tjera të interesit të cilat janë bërë pjesë e këtyre takimeve. P.sh. kemi bërë takime me përfaqësues të bizneseve, ku këta të fundit kanë patur mundësi që të identifikojnë dhe të adresojnë nevojat dhe problemet e tyre në raport me pushtetin vendor. Janë organizuar takime me të rinj dhe të reja të cilët sidomos këtë vit kanë patur mundësi që edhe në bashkëpunim me kryetarin e bashkisë të adresojnë nevojat e tyre. Për të vijuar me takime me sportistë dhe sportiste, anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian dhe jo vetëm, por ne jemi kujdesur që të lehtësojmë këtë mënyrë bashkëpunimi me të gjithë aktorët edhe të fushave të tjera në territorin e bashkisë Elbasan. P.sh. në hartimin e Planeve Vendore ne kemi përfshirë edhe universitetet si edhe target grupet e sipërpërmendura dhe rasti më i fundit ishte hartimi i Planit për Barazinë Gjinore.

LEXONI RAPORTET STUDIMORE “INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR”



Tiranë



Vlorë



Korçë



Shkodër



V.Dejës



Kukës



Elbasan



Fier



Durrës



Pogradec



Kamëz



Pukë



Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” me mbështetjen e Qeverisë Suedeze dhe “National Endowment for Democracy.”

ANËTARËT E RRJETIT POP:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave
- Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

Për çdo pyetje, kërkesë apo detaje të tjera në lidhje me rrjetin POP, kontaktoni në:

E-mail: perballjaeofertavepolitike@gmail.com

Mob: +355 (0) 69 61 20 169

Na ndiqni në kanalet tona zyrtare:

Web: popnetwork.al

Facebook: [POPNetworkAlbania](https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania)

Twitter: [POPAlbania2020](https://twitter.com/POPAlbania2020)

Instagram: [pop_perballjaeofertavepolitike/](https://www.instagram.com/pop_perballjaeofertavepolitike/)

You tube: [perballjaeofertavepolitike](https://www.youtube.com/channel/UC...)